

**Emri i Lëndës : Anglisht e Avancuar II**

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EFL 104	C	Pranverë	5.00	0.00	0.00	5.00	5.00

<b>Lektori</b>	Elvana Shtepani, PhD
<b>Asistenti</b>	
<b>Gjuha e kursit</b>	Anglisht
<b>Niveli i lëndës</b>	Bachelor

<b>Përshkrimi</b>	<p>Plani mësimor i kësaj lënde ka një strukturë të shumë anshme, e cila përfshin gramatikën, fjalorin, integrimin e të dëgjuarit, të folurit, të shkrimit dhe leximit. Gjatë leximit do të theksohen strategjitë e të kuptuarit dhe mësimin e zgjerimit të fjalorit. Studenti do të zhvillojë aftësitë e të mësuarit përmes përfshirjes së tij në detyra të ndryshme, dhe punë autonome me fjalor dhe burime të tjera të mësimin të gjuhës. Kjo lëndë synon përmirësimin e aftësive gjuhësore të studentëve dhe sidomos aftësitë në lexim dhe të kuptuarit. Tekstet për këtë kurs do të ndihmojnë studentët të përmirësojnë kuptimin e temave të ndryshme dhe fushave të studimit (p.sh., shkencë shoqërore, shkencë natyrore, dhe humane) me mënyrat e ndryshme të diskutimit (p.sh., tregim, transmetim, dhe argumentim). Studentët do të zhvillojnë të menduarin kritik përmes rëndësisë që i është dhënë inferencës gjatë gjithë semestrit. Tekstet e përdorura mbulojnë aspektet kulturore të vendeve anglisht folëse për të ndihmuar edukimin e tyre ndërkulturor. Shkrimi është zhvilluar përmes një studimi më të thellë të strukturave gramatikore dhe nëpërmjet praktikës në shkrim, teknikave të paragrafëve dhe sidomos shkrimit të eseve me pesë paragrafë. Studentët do të përmirësojnë aftësitë e tyre për të shkruar një shumëllojshmëri fjalish dhe do të angazhohen në kritikën e punës së shokut dhe editime të tekstit.</p>
-------------------	---

<b>Objektivat</b>	<p>Lënda ka për qëllim të: - Të zhvillojnë aftësitë e të folurit dhe të lexuarit. - Të përmirësojë përdorimin e strategjive të nxënies të fjalorit gjatë leximit dhe aktiviteteve specifike të caktuara për mësimin e fjalorit. - Zhvillimin e aftësive të studentëve për proceset bazë të leximit, të kuptimit dhe përdorimit të aftësive efektive për të kuptuar materialet e leximit. - Përmirësimin e aftësive të studentëve në identifikimin e tipareve dalluese të paragrafëve dhe përdorimi i tyre në kontekstin e të shkruarit. - Të bëjë studentët të demonstrojnë kuptimin e strukturave të ndryshme gramatikore në të folur dhe të shkruar: Studentët do të shpjegojnë dhe përdorin teknikën për të shkruar paragrafë, ese, ditar, letër dhe të theksojnë rëndësinë e redaktimit të shkrimit. - Të bëjë që studentët të diskutojnë, debatojnë në lidhje me tema të ndryshme shoqërore dhe akademike duke përdorur gjuhën angleze të saktë gramatike.</p>
-------------------	---

<b>Konceptet Kryesore</b>	
---------------------------	--

**Programi i Lëndës**

Java	Tema
<b>1</b>	Extremet. Leximi: nxënia e fjalorit. Gramatikë. Fjalitë e përbëra. Shkrimi dhe leximi: përshkrim i vendeve.
<b>2</b>	Gjerat nuk janë ashtu siç kanë qenë. Gramatikë: përshkrimi i zakoneve. Të folurit: diskutim. Shkrim: të shkruash për të folur.
<b>3</b>	Gjërata nuk janë ashtu siç kanë qenë: ushtrime.
<b>4</b>	Përsëritje. Ese: përshkrimi i një personi që ka lënë mbresa të thella në jetën tuaj
<b>5</b>	Rrezikimi i jetës. Gramatikë: foljet modale. Shkrimi i letrave formale dhe joformale.
<b>6</b>	Ushtrime. Shkrim në klasë.

<b>7</b>	Në ëndrrat tuaja. Leximi foljet modale. Të folurit: diskutim rreth ëndrrave
<b>8</b>	Provimi gjysmefinal
<b>9</b>	Në ëndrrat tuaja: Ushtime. Shkrim rreth ëndrrave.
<b>10</b>	Nuk është kurrë vonë. Gramatikë: hipoteza. Të folurit: biseda. Shkrimi i tregimit.
<b>11</b>	Ushtrime. Lexim.
<b>12</b>	Lexim ekstensiv.
<b>13</b>	Përmbledhje e gramatikës. Shkrim esesh I
<b>14</b>	Shkrim esesh II
<b>15</b>	Shkrim esesh III
<b>16</b>	Provimi final
<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	• Soars, J, ( 2009), New Headway Plus ( Upper intermediate), Oxford Press
<b>Referenca të tjera</b>	• -Oxford dictionary, www.oup.com/elt/headway
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>	
<b>1</b>	Studentët do të lexojnë dhe kuptojnë tekste të ndryshme të mara nga materiale autentike si gazeta revista etj.
<b>2</b>	Studentët do të flasin me saktësi fjalorin dhe gramatikën e paraqitur në mësim
<b>3</b>	Studentët do të shkruajnë letra të ndryshme si kërkesa, ankesa, letra, aplikimi, raporte apo tregime

<b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>			
<b>Notat e Ndërmjetme</b>	<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>	
Gjysmë finale	1	15	
Kuize	0	0	
Projekte	3	45	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	5	
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>65</b>	
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>35</b>	
<b>Total</b>		<b>100</b>	
<b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>			
<b>Aktivitetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>	<b>Ngarkesa Totale (orë)</b>
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	5	80
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	3	5	15
Gjysmë finale	1	5	5
Provimi final	1	7	7
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>135</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>5.40</b>
<b>ECTS</b>			<b>5.00</b>